



**Neue Coronaschutzverordnung: Land setzt vereinbarte Maßnahmen zur Bekämpfung des Corona-Virus konsequent um**

**Deklaratë për shtyp - 1010/11/2020**

**Urdhëresa e Re për Mbrojtjen nga Koronavirusi:  
Landi implementon  
në mënyrë rigoroze masat e rëna  
dakord për të luftuar koronavirusin**

**Ministria e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale ju informon:**

Qeveria e Landit do të implementojë në mënyrë rigoroze masat e rëna dakord në datën 25 nëntor gjatë takimeve të udhëheqësve dhe udhëheqëseve të qeverive të Landeve me kancelaren e Gjermanisë. Urdhëresa e Re për Mbrojtjen nga Koronavirusi përmban adaptimet e nevojshme dhe do të qëndrojë në fuqi deri në 20 dhjetor 2020 në përputhje me marrëveshjen midis udhëheqësve të qeverisë dhe kërkesave të reja ligjore federale.

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann u shpreh se: "Situata vazhdon të jetë shumë serioze. Ne kemi nevojë për një përpjekje të fuqishme kombëtare për të parandaluar një emergjencë mjekësore. Për ta bërë të mundshme këtë gjë, ne duhet të vazhdojmë të reduktojmë kontaktet, në mënyrë që të kufizojmë më tej përhapjen e infeksionit. Rregulloret e caktuara në nëntor kanë arritur ta ndalin rritjen eksponenciale, por fatkeqësisht numri i personave të infektuar nuk ka rënë aq ndjeshëm sa dëshirohet dhe sa nevojitet. Duke patur veçanërisht parasysh Kohën e Ardhjes e cila vjen së shpejti, masat e marra janë të vështira për shumë njerëz dhe kërkojnë që secili prej nesh këtë vit të distancohet nga traditat e çmuara. Tani është koha për t'u treguar të fortë."

**Përmbledhje e shkurtër e masave**

Urdhëresa e Re për Mbrojtjen nga Koronavirusi cakton masat si në vijim:

30.11.2020  
Faqja 1 nga 3

Pressestelle Staatskanzlei  
40213 Düsseldorf  
Telefon 0211 837-1134  
0211 837-1405  
ose 0211 837-1151

[presse@stk.nrw.de](mailto:presse@stk.nrw.de)  
[www.land.nrw](http://www.land.nrw)

- Takimet në hapësira publike lejohen vetëm midis pjesëtarëve të bashkësive familjare të vetë personit dhe të një tjetri. Nuk lejohen të jenë të pranishëm më shumë se pesë persona kur takohen dy bashkësi familjare, dhe fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë) nuk merren në konsideratë kur llogaritet numri i personave.
- Duhet mbajtur maska në mjediset e mbyllura. Kjo vlen gjithashtu për vendet e punës nëse nuk mbahet distanca prej 1,5 metrash me njerëzit e tjerë.
- Duhet të mbahet gjithashtu një maskë në hapësirat pranë dyqaneve të shitjes me pakicë, veçanërisht tek trualli ku gjendet dyqani, tek vendet e parkimit të cilat i përkasin dyqanit dhe tek rrugët të cilat të çojnë tek dyqani.
- Në mjedise komerciale të tilla si supermarkete, qendra tregtare dhe dyqane ku shiten produkte për rregullimin e shtëpive me një hapësirë totale shitje prej më shumë se 800 metër katror do të zënë vend kufizime të tjera në lidhje me numrin e klientëve për metër katror.
- Gjithashtu në mjediset private rekomandohet urgjentisht pajtueshmëria përkatëse me rregullat e Urdhëresës. Kjo përfshin shprehimisht rekomandimin për reduktimin e kontakteve ose zhvillimin e tyre me mbrojtje maksimale nga infeksioni, në përputhje me rregullat AHA-L.

Vlejnë gjithashtu për Kohën e Ardhjes dhe ditët e pushimit rregulloret e veçanta si në vijim:

- Shitjet e pemëve të Krishtlindjes në mënyrë komerciale ose sociale lejohen në përputhje me rregulloret për higjienën dhe mbajtjen e distancës.
- Në periudhën nga data 23 dhjetor 2020 deri në 1 Janar 2021, krahas rregulloreve të përmendura më sipër për kufizimin e kontaktit, lejohet takimi në rrethin e ngushtë familjar ose shoqëror me maksimumi 10 persona të pranishëm, ku fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë) nuk merren në

konsideratë në llogaritjen e numrit të personave. Këto persona nuk janë të ndaluar të rrinë në hotele dhe pensione për vizitat e tyre gjatë pushimeve.

- Ndalohen hedhjet në publik të fishekzjarreve gjatë periudhës së ndërrimit të viteve 2020/2021. Autoritetet vendore përgjegjëse ndalojnë gjithashtu përdorimin e lëndëve piroteknike në vende dhe rrugë specifike ku priten grupime masive njerëzish në mungesë të rregullit i cili ndalon hedhjen e fishekzjarreve. Duke patur parasysh sezonin e ardhshëm të skive vlen ky rregull: përdorimi i kabinave teleferike është momentalisht i ndaluar duke qenë se konsiderohen mjedise për shpenzimin e kohës së lirë sipas § 10 Paragrafi 1 Nr. 2 të Urdhërësës për Mbrojtjen nga Koronavirusi.

Urdhëresa e Re për Mbrojtjen nga Koronavirusi vlen duke filluar nga data 1 dhjetor 2020 dhe është e disponueshme [këtu](#).

***Për pyetje si qytetar ju lutem telefononi tek numri i telefonit: 0211 855-5.***

***Nëse keni pyetje në lidhje me zyrën e shtypit, ju lutem kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Punës, Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale, Telefon 0211 855-3118.***

***Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion tek <https://www.land.nrw/>***

**[Shënim në lidhje me mbrojtjen e të dhënave në rrjetet sociale](#)**